

## **Procedura që ndjekin funksionarët e lartë të ATP për të marr vendimeve.**

Drejtori i Përgjithshëm i ATP-së, në zbatim të përgjegjësive të ngarkuara nga ligji 133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, shprehet me vendim.

Vendimet e dhëna nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë duhet të jenë në formë të shkruar, të arsyetuara, të nënshkruara nga titullari dhe të përmbushin kërkesat për aktin administrativ, të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë. Kur vendimi nuk ankimohet brenda afateve të parashikuara nga ky ligj, ai përbën titull ekzekutiv.

Hapat për të dale në vendimmarrje:

1. Të gjithë punonjësit e ATP-së që, sipas detyrës funksionale, pranojnë, përpunojnë, plotësojnë, shqyrtojnë, hetojnë, mbikëqyrin kërkesat e subjekteve të shpronësuara, të cilat kalojnë për miratimin e vendimit përkatës te Drejtori i Përgjithshëm, sipas ligjit nr. 133/2015.

2. Pas kontrollit, vlerësimit dhe shqyrtimit të kërkesave, Drejtori i Përgjithshëm i ATP-së shprehet me vendim brenda afatit të përcaktuar në ligji, për:

- rrëzimin e kërkesës;
- njohjen, sipas rastit, të së drejtës së pronësisë, kompensimin fizik brenda kufijve të pronës së njohur apo kompensimin nga fondi i tokës ose kompensimin financiar të pasurisë dhe të të drejtave të tjera reale, sipas përcaktimeve në këtë ligj;

Drejtori i përgjithshëm i ATP-së ndjek dhe vë në dijeni Ministrinë e Drejtësisë për ecurinë e vendimmarrjes ndaj kërkesave të subjekteve të shpronësuara, për çështje të përfaqësimit të interesave ligjore të shtetit në gjykatë gjatë zgjidhjes dhe shqyrtimit të konflikteve,

- **Agjencia e Trajtimit të Pronave e ushtron veprimtarinë e saj, në bazë të:**

- Ligjit 133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave” i ndryshuar me ligjin nr.77/2022 ,

<https://atp.gov.al/ligj-nr-133-2015-per-trajtimin-e-prones-dhe-perfundimin-e-procesit-te-kompensimit-te-pronave/>

- VKM 223/2016 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin dhe ekzekutimin e vendimeve përfundimtare të kompensimit të pronës dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave”, e ndryshuar me VKM 313/2023 ,

[https://atp.gov.al/wp-content/uploads/2023/07/VKM-nr-223-date-2332016-perditesuar\\_230615\\_093952.pdf](https://atp.gov.al/wp-content/uploads/2023/07/VKM-nr-223-date-2332016-perditesuar_230615_093952.pdf)

-VKM 222/2016 “Për trajtimin e kërkesave për njohje të së drejtës së kompensimit të pronës, e ndryshuar me VKM 312/2023.

<https://planifikimi.gov.al/index.php?eID=dumpFile&t=f&f=4498&token=bd555e0d9c8ba052cae6fb64bef209488d7fa3cc>

- **Procedura që ndjekin funksionarët e lartë për marrjen e vendimeve përpos sa parashikojnë aktet e mësipërme bazohet në:**

-VKM nr 221/2016 “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë së Trajtimit të Pronës”.

<https://atp.gov.al/wp-content/uploads/2023/08/Vendim-Nr.-221-date-23-03-2016.pdf>

- Rregulloren e Brendshme të ATP-së “Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës në Agjencinë e Trajtimit të Pronës”, miratuar me Urdhërin nr. 280, datë 22.06.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm,( neni 5 e në vijim, ku në kreun III jepen dispozitat në mënyrë specifike për sejcilën drejtori)

<https://atp.gov.al/rregullore-per-organizimin-funksionimindetyrat-dhe-kompetencat-e-administrates-ne-agjencine-e-trajtimit-te-pronave-2/>

Gjithashtu gjatë ushtrimit të veprimtarisë mbahen parasysh edhe respektimi i dispozitave të :

- Ligji nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit,”

[https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2018/08/Ligj\\_119\\_2014\\_18.09.2014.pdf](https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2018/08/Ligj_119_2014_18.09.2014.pdf)

-Ligji Nr.9887, datë 10.3.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar,

[https://www.idp.al/wpcontent/uploads/2020/03/Ligj\\_Nr.9887\\_dat%C3%AB\\_10.3.2008\\_i\\_ndryshuar.pdf](https://www.idp.al/wpcontent/uploads/2020/03/Ligj_Nr.9887_dat%C3%AB_10.3.2008_i_ndryshuar.pdf)

-Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar me ligjin nr. 9475, datë 09.02.2006; me ligjin nr. 9529, datë 11.05.2006; me ligjin nr. 86/2012 datë 18.09.2012 dhe me Ligjin nr. 44/2014 datë 24.04.2014.

[https://www.idp.al/wp-content/uploads/2017/03/Ligji\\_nr\\_9367\\_i\\_perditesuar.pdf](https://www.idp.al/wp-content/uploads/2017/03/Ligji_nr_9367_i_perditesuar.pdf)

-Ligji nr. Nr.9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”

[https://www.dap.gov.al/images/LegjislacioniAP/Ligj\\_Nr.9154\\_dat%C3%AB\\_6.11.2003\\_Per\\_arkivat.pdf](https://www.dap.gov.al/images/LegjislacioniAP/Ligj_Nr.9154_dat%C3%AB_6.11.2003_Per_arkivat.pdf)

-Vendim nr. 4, datë 19.6.2017 për miratimin e “Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë”

<https://www.adisa.gov.al/wp-content/uploads/2019/12/vendim-2017-06-19-4.pdf>